



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**  
**ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT**  
**TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE**  
**PROCUREMENT REVIEW BODY**

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) Rruga "MIGJENI" (ish-Banka e Lubjanës) Kati V-të, Prishtinë, Kosovë  
Tel:+ 383 38 212 309 e-mail: oshp@rks-gov.net

**PSH. Nr. 446/23**

**Nr. 455/23**

**Nr. 456/23**

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP) në përbërje nga Vedat Poterqoi Kryetar i panelit shqyrtues, duke vendosur sipas ankesave të (OE) "Lindi Markings" Sh.P.K., "Sinjalizimi" Sh.P.K.& "El-Bau" Sh.P.K, kundër Vendimit për anulimin e procedurës së prokurimit të Komuna e Vushtrrisë, në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit "Mirëmbajtja e sinjalizimit horizontal dhe vertikal" me numër të prokurimit VU644-22-8873-2-2-1, me 31/08/2023, mori:

#### V E N D I M

1. Anulohet, në tërësi aktiviteti i prokurimit "Mirëmbajtja e sinjalizimit horizontal dhe vertikal", me numër të prokurimit VU644-22-8873-2-2-1, iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK)-Komuna e Vushtrrisë.
2. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informojë OSHP-në për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën për mosrespektim të vendimit, OSHP mund të ndërmarrë masa ndaj AK, sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik në Kosovë.
3. Lejohet kthimi i shumës së deponuar me rastin e parashtrimit të ankesave dhe obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 31 pika 6 të Rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

## A r s y e t i m

### *- Faktet dhe rrethanat procedurale –*

Me 31.08.2022, Komuna e Vushtrrisë, në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë. Hapja e ofertave është bërë me datë 21.09.2022, Me datë 06.06.2023, AK ka publikuar B58 Njoftimin Mbi Vendimin për anulim të aktivitetit të prokurimit “Mirëmbajtja e sinjalizimit horizontal dhe vertikal” me numër të prokurimit VU644-22-8873-2-2-1.

Me datë 08.06.2023, Operatori Ekonomik “Lindi Markings” Sh.P.K., ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim pranë AK- Komuna e Vushtrrisë dhe me 26.06.2023, Autoriteti Kontraktues, Komuna e Vushtrrisë, e ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën për rishqyrtim dhe e ka vërtetuar B58 njoftimin mbi vendimin autoritetit kontraktues të datës 06.06.2023.

Me datë 08.06.2023, Operatori Ekonomik “Sinjalizimi” Sh.P.K., ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim pranë AK- Komuna e Vushtrrisë dhe me 21.06.2023, Autoriteti Kontraktues, Komuna e Vushtrrisë, e ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën për rishqyrtim dhe e ka vërtetuar B58 njoftimin mbi vendimin autoritetit kontraktues të datës 06.06.2023.

Me datë 08.06.2023, Operatori Ekonomik “El-Bau” Sh.P.K., ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim pranë AK- Komuna e Vushtrrisë dhe me 06.06.2023, Autoriteti Kontraktues, Komuna e Vushtrrisë, e ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën për rishqyrtim dhe e ka vërtetuar B58 njoftimin mbi vendimin autoritetit kontraktues të datës 06.06.2023.

Me datën 30.06.2023, Operatori Ekonomik “Lindi Markings” Sh.P.K., ka parashtruar ankesë në OSHP-ë, me numër të protokollit 446/2023, për aktivitetin e prokurimit të përshkruar si më sipër.

Me datën 02/07/2023, Operatori Ekonomik “Sinjalizimi” Sh.P.K., ka parashtruar ankesë në OSHP-ë, me numër të protokollit 455/2023, për aktivitetin e prokurimit të përshkruar si më sipër.

Me datën 03/07/2023, Operatori Ekonomik “El-Bau” Sh.P.K., ka parashtruar ankesë në OSHP-ë, me numër të protokollit 456/2023, për aktivitetin e prokurimit të përshkruar si më sipër.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: shërbim, vlera e parashikuar e kontratës: **110,000.00 €**.

Ankesa e OE është ushtruar në pajtim me nenin 109.1, të LPP, sipas të cilit kundër çdo vendimi të marrë nga AK çdo palë e interesuar mund të parashtrorë ankesë pranë OSHP. Meqë OE ka ushtruar po ashtu kërkesë për rishqyrtim, do të thotë se veprimet e të njëjtit i referohen po ashtu dhe nenit 108/A të Ligjit të cituar. Prandaj OSHP konsideron se ankesa i plotëson kushtet e parapara në kuptim të dispozitave tani më të cituara dhe e njëjta bie nën kompetencat e tij në kuptim të nenit 105, të LPP. Palët janë njoftuar palët me raportin e ekspertizës me datë: 14 Korrik 2023.

### *- Vlerësimi dhe administrimi i provave –*

Bazuar në veprimet e përshkruara si më sipër, OSHP ka angazhuar ekspertin vlerësues në pajtim me nenin 111, paragrafi 5 të LPP, me detyrë që i njëjti në kuptim të nenit 113 të Ligjit të cituar, ta bëjë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve ankimore, përkitazi me aktivitetin e prokurimit të përshkruar si më sipër. Lidhur me këtë, me 14.07.2023, ekspertja shqyrtuese ka dorëzuar Raportet e vlerësimit me rekomandimet si në vijim:

-ankesa OE “Lindi Markings” Sh.P.K., “Sinjalizimi” Sh.P.K.& “El-Bau” Sh.P.K., të aprovohen si e bazuar.

- të mbet në fuqi Njoftimi mbi Vendimin e AK-së i datës 06.06.2023, *(njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit)*.

Paneli Shqyrtues konsideroi se lidhur me çështjen në rastin konkret, nuk ka nevojë të konvokohet seanca dëgjimore me palë, konform nenit 24 paragrafi 1, i Rregullores së Punës së OSHP, përderisa pretendimet e palëve, provat, parashtrësat e tyre dhe ekspertiza e ekspertit shqyrtues, ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritot.

#### Përgjigje në pretendimet ankimore të OE ankues “Lindi Markings” Sh.P.K., me seli në Pejë

Autoriteti Kontraktues Komuna e Vushtrisë për këtë aktivitet të prokurimit ka përdor procedurë të hapur, lloji i kontratës është kontratë kornizë – shërbime, vlera e parashikuar e kontratës është 110,000.00€. Kriteret e Dhënies së kontratës janë tenderi i përgjegjshëm me Çmimin më të ulët.

Sqarim hyrës:

Me datë 31.08.2022 është publikuar njoftimi për kontratë, kurse hapja e ofertave është bërë me datë 21.09.2022. Sipas platformës së e-prokurimit, nga data 21.09.2022 deri me datë 06.06.2023, AK nuk ka ndërmarr asnjë veprim për ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve, ku me datë 06.06.2023 kishte bërë anulimin e këtij aktiviteti të prokurimit. Përmes dokumentit “Njoftim mbi vendimin e AK-së” janë informuar tenderuesit se është anuluar aktiviteti i prokurimit me arsyetimin se kanë kaluar disa muaj nga data e njoftimit për kontratë dhe për pasojë ka skaduar kohëzgjatja e ofertave (periudha e vlefshmërisë së tenderit në Dosjen e Tenderit). Arsye tjetër është cekur se pasi që procedura ishte iniciuar në vitin 2022 dhe mjetet financiare të parapara për këtë projekt kanë kaluar në Buxhetin e Kosovës.

Pas analizimit të ankese dhe pretendimeve ankimor kemi gjetur se ankesa bazohet në tri çështje kryesore.

- Stërzgjatja dhe vonesa në ekzaminimin dhe vlerësimin e tenderëve në kundërshtim me nenin 40.1 dhe 40.3 të Rregullores Nr. 001/2022
- Mos kërkimi i zgjatjes së validitetit të ofertave nga ana e autoritetit kontraktues në kundërshtim me nenin 30.4 të Rregullores Nr. 001/2022
- Marrja e masave karshi shkeljeve të autoritetit kontraktues për këtë aktivitet të prokurimit në kundërshtim me nenin 97.1 pika f) dhe pika k) të Rregullores Nr. 001/2022
- Anulimi i aktivitetit të prokurimit në kundërshtim me nenin 62 të LPP-së

Ekspertja shqyrtuese pas shqyrtimit të shkresave të lëndës sqaron se me datë 31.08.2022, ora 12:20, AK ka ngarkuar dokumentin “B04 Deklarata e Nevojave dhe Përcaktimit të Disponueshmërisë së fondeve” në platformën e-prokurimit, ndërsa vlera e parashikuar e kontratës sipas këtij dokumenti është 110,000.00 euro. Në të njëjtën ditë (31.08.2022) në ora 17:45 e bënë publikimin e “Njoftim për Kontratë”. Në bazë të njoftimit për kontratë, 8 operator ekonomik kishin shprehur interesim dhe të cilët kishin ofertuar. Pas dorëzimit të ofertave, AK me datë 21.09.2022, ora 14:00:00, kishte bërë hapjen e ofertave. Ndërsa prej datës **21.09.2022** deri me datë **06.06.2023**, AK nuk kishte ndërmarr asnjë veprim për të bërë ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve, ku tek me datë 06.06.2023, ora 10:10 ngarkohet dokumenti “B58 Njoftim mbi vendimin e autoriteti kontraktues”, sipas të cilit dokument anulohet procedura me arsyetimin se kanë kaluar disa muaj nga data e hapjes së ofertave, ka skaduar kohëzgjatja e vlefshmërisë së ofertave sipas afatit të saktësuar në Njoftimin për Kontratë, nenin IV, 3.3 dhe nenin IV.5 të Dosjes së Tenderit. Në këtë njoftim për anulim, AK thekson se arsye tjetër është edhe mjetet financiare të parapara kanë kaluar në buxhetin e Kosovës.

Ekspertja shqyrtuese sqaron se arsyet e AK-së për anulimin e këtij aktiviteti të prokurimit janë të pa qëndrueshme për shkak se nuk justifikohet në asnjë mënyrë mos ndërmarrja e veprimeve në kryerjen e detyrave dhe përgjegjësi të zyrtarëve duke shkaktuar vonesa në vlerësim mbi 8 muaj. AK nuk ka dhënë asnjë arsyetim se çfarë e ka shkaktuar vonesën në vlerësimin e ofertave dhe me këtë ka vepruar në kundërshtim me nenin 40.1 dhe 40.3 të Rregullores nr.001/2022, ku kjo dispozitë ligjore përcakton se ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve do të kryhet brenda 30 ditëve, në raste të jashtëzakonshme dhe të justifikuara mund të zgjatet me afat shtesë prej 20 ditëve.

Ekspertja shqyrtuese sqaron se AK me datë 31.08.2022, ora 12:20, ka ngarkuar dokumentin “B04 Deklarata e Nevojave dhe Përcaktimit të Disponueshmërisë së fondeve”, ku ka qenë përgjegjësi dhe detyrë e AK-së që të bëjë ekzaminimin dhe vlerësimin e tenderëve brenda afateve ligjore të përcaktuara në nenin 40.1 dhe 40.3 të Rregullores nr.001/2022. Ndërsa në lidhje me pikën ankimore se sipas web faqes së AK-së Komuna Vushtrri është publikuar buxheti për vitin fiskal 2022 ku ky aktivitet i prokurimit është evidentuar, po ashtu edhe në buxhetin e vitit 2023 është evidentuar ky projekt dhe vlera e këtij projekti, tutje OE ankues pretendon se anulimi i aktivitetit të prokurimit me arsyetim të tillë bie ndesh me dispozitat ligjore dhe parimet prokurimit publik dhe me përgjegjësin e pozitën se zyrtare, të zyrtarit përgjegjës të prokurimit. Këtë fakt e argumenton edhe neni 97 pika k) i Rregullores nr. 001/2022 që përcaktohet si shkelje e rend ligjore “*anulimin e aktivitetit të prokurimit në kundërshtim me nenin 62 të Ligjit të Prokurimit Publik*”. Ekspertja shqyrtuese sqaron se OE ankues me ankesë ka bashkëngjitur provë tabelën 4.2 financimi i investimeve kapitale 2022 dhe tabelën 4.2 financimi i investimeve kapitale 2023. Pretendimi i OE ankues është i bazuar për faktin se bazuar në këto prova rezulton se për projektin “Sinjalizimi horizontal dhe vertikal” janë paraparë mjete. Sa i përket pretendimit se anulimi i aktivitetit të prokurimit me arsyetim pa bazë bie ndesh me dispozitat ligjore dhe parimet prokurimit publik dhe me përgjegjësin e pozitën se zyrtare, të zyrtarit përgjegjës të prokurimit përkatësisht neni 97 pika k) i Rregullores nr. 001/2022 që përcaktohet si shkelje e rend ligjore “*anulimin e aktivitetit të prokurimit në kundërshtim me nenin 62 të Ligjit të Prokurimit Publik*”. Ekspertja shqyrtuese sqaron se arsyetimi i AK-së është i pa qëndrueshëm, andaj i propozoj bordit të Oshp-së, që të merren masa sipas procedurave dhe rregullave në fuqi ku këtë propozim e bazoj në nenin 97.1 pika k) të Rregullores Nr. 001/2022.

Lidhur me pretendimin e OE ankues se mos përgjegjësia dhe vonesat në vlerësimin e ofertave me qëllim të caktuar të zyrtareve përgjegjës të prokurimit bien ndesh me nenin 40,4.1 dhe 4.3 të Rregullores nr.001/2022 po ashtu edhe arsytimi i anulimit të aktivitet të prokurimit bie ndesh me nenin 62 të LPP-së . Ekspertja shqyrtuese vlerëson se pretendimi i OE ankues është i bazuar sepse vonesat në vlerësim kanë ndodhur për shkak të AK-së mirëpo AK nuk ka dhënë sqarime apo arsye se çfarë e ka shkaktuar vonesën në vlerësim të ofertave. Po ashtu autoriteti kontraktues në arsyetimin e datës 21.06.2023 nuk ka provuar të dëshmojë me ndonjë dëshmi konkrete në lidhje me mungesën e mjeteve ashtu siç pretendon, ku këtë e dëshmon edhe provat e bashkangjitura nga OE ankues që ky aktiviteti i prokurimit është evidentuar në financimin e investimeve kapitale për vitin 2022 dhe 2023.

Lidhur me pretendimin e OE ankues se autoriteti kontraktues në vazhdimësi ka kërkuar vazhdimin e validitetit të ofertës ku ne si OE kemi ofruar validitet. Tutje OE ankues shton se për këtë çështje OSHP-përmes vendimeve është vendosur ndryshe Vendimi 362/22;346/22; 342/22 etj.

Bazuar në platformën e prokurimit kërkesa e AK-së e (fundit )për vazhdimin e validitetit të ofertave ka qen me datë 22.03.2023, ndërsa oferta e operatorit ekonomik ankues ka pas validitet deri me datë 21.05.2023. Ekspertja shqyrtuese sqaron se AK është përgjegjëse që të kërkoj nga operatorët ekonomik të zgjatin validitetin e tenderëve të tyre. Këtë konstatim e bazoj në nenin 30.4 i Rregullores Nr.001/2022 ku është përcaktuar ....“Kërkesa për zgjatje të validitetin të tenderit do të bëhet me shkrim dhe duhet të kërkohet para datës së skadimit dhe duhet të ngritet në sistem (është e rëndësishme të verifikohet që të gjithë tenderët pranojnë kërkesën për zgjatjen e validitetit të tenderit). Andaj Autoritetit kontraktues është përgjegjës që të ndërmarr veprime në kuptime të nenit 30.4 dhe 30.5 të Rregullores Nr. 001/2022. Po ashtu ekspertja sqaruese sqaron se mos zbatimi i nenit 30.4 klasifikohet si shkelje e rend sipas nenit 97.1 pika f) të Rregullores Nr. 001/2022 për prokurim publik në të cilin thuhet: *“f. Mos zbatimi i nenit 30.4 të Rregullores së Prokurimit Publik nga zyrtari përgjegjës i prokurimit dhe si rrjedhojë skadimi të afateve kohore të vlefshmërisë dhe sigurisë së tenderëve”*

**Prove:**

## VALIDITETI I OFERTES

LINDI MARKINGS sh.p.k me adres ne Vitomerfo rejonit II p.a. Peje me nr.UNIK- 011206526 Drejtor Z. Fatmir Gjehaj

NE VAZHDIJM VALIDITETIN E OFERTES EDHE PER 60 DITE nga dat, 21.03.2023 Deri me dat, 21.05.2023 sipas kerkeses se AK -R.E. vashiteti

LINDI MARKINGS sh.p.k Per aktivitetin e prokurimit me titull:

Nr i prokurimit	VUN/14-23-0073.1.3.1
Nr i licencimit	VUN/14/23/114/131

Titulli: Mirembajtja e Sinjalizimit Horizontal dhe Vertikal

Lindi Markings sh.p.k  
000000  
Fatmir Gjehaj



Sa i përket vendimeve të OSHP-së, të cilave ju ka referuar OE ankues se është vendosur ndryshe ekspertja shqyrtuese sqaron se nuk mund ti komentoj vendimet e OSHP-së sepse nuk është në kompetencë të ekspertit që të bëjë vlerësime apo komente në vendime të OSHP-së.

Lidhur me pretendimin e OE ankues se AK-së përveç qe i është dashur rreth 8 muaj për të vlerësuar ofertat i janë dashur edhe 10 dite për të trajtuar kërkesën për rishqyrtim ku një veprim i tillë bie ndesh me nenin 108/A paragrafin 6 të LPP-së, ekspertja shqyrtuese sqaron se pretendimi i OE ankues është i bazuar për faktin se në paragrafi 6 të nenit 108/A të LPP-së, është përcaktuar se *“Autoriteti kontraktues do ta shqyrtojë kërkesën brenda tre (3) ditë pune nga data e dorëzimit të aplikimit ose, kur është e zbatueshme, nga data e marrjes së informative shtesë dhe dokumenteve të parashikuara në paragrafin 5 të këtij neni. Afati i përmendur më lart, në raste specifike të justifikuara mund të zgjatet për jo më shumë se tre (3) ditë shtesë, dhe ankuesi do të informohet për këtë.”*

Duke u bazuar në ecurinë e këtij aktiviteti të prokurimi ekspertja shqyrtuese vlerëson se ky aktivitet i prokurimit si proces nuk është proceduar konform afateve ligjore të LPP-së dhe Rregullores Nr. 001/2022, ku si pasojë e neglizhencës dhe pa-përgjegjësisë të autoritetit kontraktues, pëson operatori ekonomik. Po ashtu duke ju referuar edhe interpretimit të KRPP-së që është organ rregullativ dhe i vetmi i cili interpreton (neni 87, par. 2.7 i LPP-së) dispozitat e LPP-së, si dhe interpretimin për çdo dokument që nxirret nga KRPP, që në rastin konkret “Rregulloren nr.001/2022 për Prokurimit Publik” është dokument i nxjerr nga KRPP, ekspertja sqaron se tek pyetjet e shpeshta 7. 22.11.2022 është dhen sqarim ..... *“Neni 30.3 i Rregullores për Prokurimin Publik, kërkon rreptësishtë që oferta të ketë validitet deri te dhënia dhe nënshkrimi*

*i kontratës. Prandaj KRPP konsideron se asnjë kontratë publike nuk mund të nënshkruhet me validitet të skaduar të ofertës. Për këtë arsye, Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit duhet me kujdesin më të madh të përcjellë validitetin e ofertave, dhe në çdo rast duhet të kërkojë nga të gjithë operatorët ekonomik pjesëmarrës zgjatjen e validitetit të ofertave para datës së skadimit. Në mënyrë retroaktive nuk mund të kërkohet zgjatja e validitetit të ofertave dhe/ose e sigurisë së tenderit. KRPP do të monitorojë me kujdes të veçantë autoritetet kontraktuese për moszbatimin e nenit 30.4 të Rregullores për Prokurimin Publik. Mos zbatimi i nenit 30.4 klasifikohet si shkelje e rëndë sipas nenit 97 të kësaj rregulloreje, andaj KRPP do të ndërmarr masa në përputhje me nenin 97 të Rregullores për Prokurimin Publik.*

Andaj konsideroj se vendimin për anulim të aktivitetit të prokurimit duhet të mbetet në fuqi për faktin se oferta e OE ankues nuk posedon validitet dhe “Në mënyrë retroaktive nuk mund të kërkohet zgjatja e validitetit të ofertave dhe/ose e sigurisë së tenderit “, sa i përket ankesës së OE ankues, ekspertja konsideron se duhet të trajtohet si e bazuar për arsye të se anulimi i aktiviteti të prokurimit është bërë për shkak të neglizhencës së autoritetit kontraktues ku si pasoj janë penalizuar operatorët ekonomik .

Sa për sqarim dhe në shërbim të transparencës, ekspertja shqyrtuese sqaron se me datë 12.07.2023, përmes e-malit zyrtar i jemi drejtuar autoritetit kontraktues Komuna Vushtrri për sqarime në lidhje me kërkesën për zgjatje e validitetit të ofertave. Në lidhje me këtë kërkesë nuk kemi pranuar përgjigje nga Komuna e Vushtrrisë, deri me datën e lëshimit të këtij raporti (14.07.2023) nuk kam pranuar përgjigje.

Përgjigje në pretendimet ankimore të OE ankues “Sinjalizimi” Sh.P.K., me seli në Suharekë

Pas analizimit të ankese dhe pretendimeve ankimor kemi gjetur se ankesa bazohet në tri çështje kryesore.

- Stërzgjatja dhe vonesa në ekzaminimin dhe vlerësimin e tenderëve në kundërshtim me nenin 40.1 dhe 40.3 të Rregullores Nr. 001/2022
- Mos kërkitimi i zgjatjes së validitetit të ofertave nga ana e autoritetit kontraktues në kundërshtim me nenin 30.4 të Rregullores Nr. 001/2022
- Marrja e masave karshi shkeljeve të autoritetit kontraktues për këtë aktivitet të prokurimit në kundërshtim me nenin 97.1 pika f) dhe pika k) të Rregullores Nr. 001/2022
- Anulimi i aktivitetit të prokurimit në kundërshtim me nenin 62 të LPP-së

Ekspertja shqyrtuese pas shqyrtimit të shkresave të lëndës sqaron se me datë 31.08.2022, ora 12:20, AK ka ngarkuar dokumentin “B04 Deklarata e Nevojave dhe Përcaktimit të Disponueshmërisë së fondeve” në platformën e-prokurimit, ndërsa vlera e parashikuar e kontratës sipas këtij dokumenti është 110,000.00 euro. Në të njëjtën ditë (31.08.2022) në ora 17:45 e bënë publikimin e “Njoftim për Kontratë”. Në bazë të njoftimit për kontratë, 8 operator ekonomik kishin shprehur interesim dhe të cilët kishin ofertuar. Pas dorëzimit të ofertave, AK me datë 21.09.2022, ora 14:00:00, kishte bërë hapjen e ofertave. Ndërsa prej datës **21.09.2022** deri me datë **06.06.2023**,

AK nuk kishte ndërmarr asnjë veprim për të bërë ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve, ku tek me datë 06.06.2023, ora 10:10 ngarkohet dokumenti “B58 Njoftim mbi vendimin e autoriteti kontraktues”, sipas të cilit dokument anulohet procedura me arsyetimin se kanë kaluar disa muaj nga data e hapjes së ofertave, ka skaduar kohëzgjatja e vlefshmërisë së ofertave sipas afatit të saktësuar në Njoftimin për Kontratë, nenin IV, 3.3 dhe nenin IV.5 të Dosjes së Tenderit. Në këtë njoftim për anulim, AK thekson se arsye tjetër është edhe mjetet financiare të parapara kanë kaluar në buxhetin e Kosovës.

Ekspertja shqyrtuese sqaron se arsyet e AK-së për anulimin e këtij aktiviteti të prokurimit janë të pa qëndrueshme për shkak se nuk justifikohet në asnjë mënyrë mos ndërmarrja e veprimeve në kryerjen e detyrave dhe përgjegjësi të zyrtarëve duke shkaktuar vonesa në vlerësim mbi 8 muaj. AK nuk ka dhënë asnjë arsyetim se çfarë e ka shkaktuar vonesën në vlerësimin e ofertave dhe me këtë ka vepruar në kundërshtim me nenin 40.1 dhe 40.3 të Rregullores nr.001/2022, ku kjo dispozitë ligjore përcakton se ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve do të kryhet brenda 30 ditëve, në raste të jashtëzakonshme dhe të justifikuara mund të zgjatet me afat shtesë prej 20 ditëve. Po ashtu AK me datë 31.08.2022, ora 12:20, ka ngarkuar dokumentin “B04 Deklarata e Nevojave dhe Përcaktimit të Disponueshmërisë së fondeve”, ku ka qenë përgjegjësi dhe detyrë e AK-së që të bëjë ekzaminimin dhe vlerësimin e tenderëve brenda afateve ligjore të përcaktuara në nenin 40.1 dhe 40.3 të Rregullores nr.001/2022, po ashtu edhe arsyetimi i AK-së për mungesë të mjeteve financiarë është i pa qëndrueshëm sepse nuk ka provuar të dëshmojë me ndonjë dëshmi konkrete në lidhje me mungesën e mjeteve ashtu siç pretendon në arsyetimin e datës 21.06.2023.

Lidhur me validitetin e ofertave ekspertja shqyrtuese sqaron se bazuar në platformën e prokurimit kërkesa e AK-së e (fundit )për vazhdimin e validitetit të ofertave ka qen me datë 22.03.2023, ndërsa oferta e operatorit ekonomik ankues ka pas validitetet deri me datë 21.05.2023.

Ekspertja shqyrtuese sqaron se AK është përgjegjëse që të kërkoj nga operatorët ekonomik të zgjatnin validitetin e tenderëve të tyre. Këtë konstatim e bazoj në nenin 30.4 i Rregullores Nr.001/2022 ku është përcaktuar ....“Kërkesa për zgjatje të validitetit të tenderit do të bëhet me shkrim dhe duhet të kërkohet para datës së skadimit dhe duhet të ngritet në sistem (është e rëndësishme të verifikohet që të gjithë tenderët pranojnë kërkesën për zgjatjen e validitetit të tenderit). Andaj Autoritetit kontraktues është përgjegjës që të ndërmarr veprime në kuptime të nenit 30.4 dhe 30.5 të Rregullores Nr. 001/2022. Po ashtu ekspertja sqaruese sqaron se mos zbatimi i nenit 30.4 klasifikohet si shkelje e rend sipas nenit 97.1 pika f) të Rregullores Nr. 001/2022 për prokurim publik në të cilin thuhet: “f. Mos zbatimi i nenit 30.4 të Rregullores së Prokurimit Publik nga zyrtari përgjegjës i prokurimit dhe si rrjedhojë skadimi të afateve kohore të vlefshmërisë dhe sigurisë së tenderëve”

**Prove:**



**DEKLARATË MBI KËRKESËN PËR ZGJATJEN E VALIDITETIT TË OFERTËS**

Në bazë të kërkesës për zgjatjen e validitetit të ofertave për tenderin "Mirëmbajtja e sinjalizimit horizontal dhe vertikal," me Nr të prokurimit VU644-22-8873-2-2-1 dhe Nr i brendshëm Vu644-22-114-221, SINJALIZIMI SH.P.K., ju konfirmim se pajtohet për vazhdimin e vlefshmërisë së ofertës sipas kërkesës së AK bazuar në Rregulloren dhe Udhëzuesin Operativ për Prokurim Publik Neni 31.6 Validiteti i Tenderit paragrafi 4 që të zgjatet validiteti i ofertave nga data 21.03.2023 deri me 21.05.2023 dhe sipas kërkesës së Autoritetit Kontraktues Komuna e Vushtrrisë.

Identifikimi i Operatorit Ekonomik (OE)	
Emri i OE:	SINJALIZIMI SH.P.K.
Adresa e plotë:	VRANIO, SUHAREKË
Përfaqësuar nga:	
Emri	REFKI LLUGANJHA
Pozita	DIREKTOR
Nënshkrimi	
Data	23.03.2023
Vufo	

Duke u bazuar në ecurinë e këtij aktiviteti të prokurimit ekspertja shqyrtuese vlerëson se ky aktivitet i prokurimit si proces nuk është proceduar konform afateve ligjore të LPP-së dhe Rregullores Nr. 001/2022, ku si pasojë e neglizhencës dhe pa-përgjegjësisë të autoritetit kontraktues, pëson operatori ekonomik. Po ashtu duke ju referuar edhe interpretimit të KRPP-së që është organ rregullativ dhe i vetmi i cili interpreton (neni 87, par. 2.7 i LPP-së) dispozitat e LPP-së, si dhe interpretimin për çdo dokument që nxirret nga KRPP, që në rastin konkret "Rregulloren nr.001/2022 për Prokurimin Publik" është dokument i nxjerr nga KRPP, ekspertja sqaron se tek pyetjet e shpeshta 7. 22.11.2022 është dhënë sqarim ..... "*Neni 30.3 i Rregullores për Prokurimin Publik, kërkon rreptësisht që oferta të ketë validitet deri te dhënia dhe nënshkrimi i kontratës. Prandaj KRPP konsideron se asnjë kontratë publike nuk mund të nënshkruhet me validitet të skaduar të ofertës. Për këtë arsye, Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit duhet me kujdesin më të madh të përcjellë validitetin e ofertave, dhe në çdo rast duhet të kërkojë nga të gjithë operatorët ekonomik pjesëmarrës zgjatjen e validitetit të ofertave para datës së skadimit. Në mënyrë retroaktive nuk mund të kërkohej zgjatja e validitetit të ofertave dhe/ose e sigurisë së tenderit. KRPP do të monitorojë me kujdes të veçantë autoritetet kontraktuese për moszbatimin e nenit 30.4 të Rregullores për Prokurimin Publik. Mos zbatimi i nenit 30.4 klasifikohet si shkelje e rëndë sipas nenit 97 të kësaj rregulloreje, andaj KRPP do të ndërmarr masa në përputhje me nenin 97 të Rregullores për Prokurimin Publik.*"

Andaj konsideroj se vendimin për anulim të aktivitetit të prokurimit duhet të mbetet në fuqi për faktin se oferta e OE ankues nuk posedon validitet dhe "*Në mënyrë retroaktive nuk mund të kërkohej zgjatja e validitetit të ofertave dhe/ose e sigurisë së tenderit*", sa i përket ankesës së OE ankues, ekspertja konsideron se duhet të trajtohet si e bazuar për arsye se anulimi i aktiviteti të prokurimit është bërë për shkak të neglizhencës së autoritetit kontraktues ku si pasojë janë penalizuar operatorët ekonomik .

Sa për sqarim dhe në shërbim të transparencës, ekspertja shqyrtuese sqaron se me datë 12.07.2023, përmes e-malit zyrtar i jemi drejtuar autoritetit kontraktues Komuna Vushtrri për sqarime në lidhje me kërkesën për zgjatje e validitetit të ofertave. Në lidhje me këtë kërkesë nuk kemi pranuar përgjigje nga Komuna e Vushtrrisë, deri me datën e lëshimit të këtij raporti (14.07.2023) nuk kam pranuar përgjigje.

#### Përgjigje në pretendimet ankimore të OE ankues “El-Bau” Sh.P.K me seli në Gjilan

Pas analizimit të ankese dhe pretendimeve ankimor kemi gjetur se ankesa bazohet në tri çështje kryesore

Stërzgjatja dhe vonesa në ekzaminimin dhe vlerësimin e tenderëve në kundërshtim me nenin 40.3 të Rregullores Nr. 001/2022

- Mos kërkitimi i zgjatjes se validitetit të ofertave nga ana e autoritetit kontraktues në kundërshtim me nenin 30.4 të Rregullores Nr. 001/2022
- Marrja e masave karshi shkeljeve të autoritetit kontraktues për këtë aktivitet të prokurimit në kundërshtim me nenin 97.1 pika f) dhe k) të Rregullores Nr. 001/2022
- Anulimi i aktivitetit të prokurimit në kundërshtim me nenin 62 të LPP-së
- Ekspertja shqyrtuese pas shqyrtimit të shkresave të lëndës sqaron se me datë 31.08.2022, ora 12:20, AK ka ngarkuar dokumentin “B04 Deklarata e Nevojave dhe Përcaktimit të Disponueshmërisë së fondeve” në platformën e-prokurimit, ndërsa vlera e parashikuar e kontratës sipas këtij dokumenti është 110,000.00 euro. Në të njëjtën ditë (31.08.2022) në ora 17:45 e bënë publikimin e “Njoftim për Kontratë”. Në bazë të njoftimit për kontratë, 8 operator ekonomik kishin shprehur interesim dhe të cilët kishin ofertuar. Pas dorëzimit të ofertave, AK me datë 21.09.2022, ora 14:00:00, kishte bërë hapjen e ofertave. Ndërsa prej datës 21.09.2022 deri me datë 06.06.2023, AK nuk kishte ndërmarr asnjë veprim për të bërë ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve, ku tek me datë 06.06.2023, ora 10:10 ngarkohet dokumenti “B58 Njoftim mbi vendimin e autoriteti kontraktues”, sipas të cilit dokument anulohet procedura me arsyetimin se kanë kaluar disa muaj nga data e hapjes së ofertave, ka skaduar kohëzgjatja e vlefshmërisë së ofertave sipas afatit të saktësuar në Njoftimin për Kontratë, nenin IV, 3.3 dhe nenin IV.5 të Dosjes së Tenderit. Në këtë njoftim për anulim, AK thekson se arsye tjetër është edhe mjetet financiare të parapara kanë kaluar në buxhetin e Kosovës.

Ekspertja shqyrtuese konsideron se pretendimi i OE ankues është i bazuar dhe arsyet e AK-së për anulimin e këtij aktiviteti të prokurimit janë të pa qëndrueshme për shkak se nuk justifikohet në asnjë mënyrë mos ndërmarrja e veprimeve në kryerjen e detyrave dhe përgjegjësi të zyrtarëve duke shkaktuar vonesa në vlerësim mbi 8 muaj. AK nuk ka dhënë asnjë arsyetim se çfarë e ka shkaktuar vonesën në vlerësimin e ofertave dhe me këtë ka vepruar në kundërshtim me nenin 40.3 të Rregullores, ku kjo dispozitë ligjore përcakton se ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve do të kryhet brenda 30 ditëve, në raste të jashtëzakonshme dhe të justifikuara mund të zgjatet me afat shtesë prej 20 ditëve.

Ekspertja shqyrtuese sqaron se AK me datë 31.08.2022, ora 12:20:20, ka ngarkuar dokumentin “B04 Deklarata e Nevojave dhe Përcaktimit të Disponueshmërisë së fondeve”, ku ka qenë përgjegjësi dhe detyrë e AK-së që të bëjë ekzaminimin dhe vlerësimin e tenderëve brenda afateve ligjore të përcaktuara në nenin 40.3 të Rregullores. Ndërsa në lidhje me pikën ankimore se sipas tabelave buxhetore janë ndarë mjetë nga të hyrat vetanake dhe granti qeveritar për realizimin e këtij projekti, ekspertja shqyrtuese sqaron se OE ankues me ankesë ka bashkëngjitur tabelën e Buxhetit të Kosovës për vitin 2022, dhe projeksionet e buxhetit për vitin 2023, dhe 2024, ku rezulton se për projektin “Sinjalizimi horizontal dhe vertikal” janë paraparë mjete. Andaj, arsyetimi i AK-së është i pa qëndrueshëm, kurse pretendimet e ankuesit janë të bazuara.

Ne lidhje me pretendimit e OE ankues, se vendimi K.R.nr.114/2022 i datës 21.06.2023 përmes të cilit është refuzuar kërkesa për rishqyrtim si e pa bazuar, janë arsye të pa bazuara në raport me faktet, rrethanat dhe bazën ligjore. Arsyetimi i këtij vendimi në pjesën më të madhe i referohet parafrazimit të arsyetimit të vendimit për anulim të aktivitetit të prokurimit dhe në pjesën tjetër të paraqitjes së fakteve të rreme pasi që në arsyetimin e vendimit të kundërshtuar nuk janë paraqitur dhe sqaruar faktet dhe rrethanat të cilat kanë qenë shkaqe vendimtare që e kanë tej zgjatur procesin e vlerësimit për 8 muaj e gjysmë, nga data 21.09.2022 deri me datë 06.06.2023.

Ekspertja shqyrtuese vlerëson se pretendimi i OE ankues është i bazuar sepse vonesat në vlerësim kanë ndodhur për shkak të AK-së mirëpo AK nuk ka dhënë sqarime apo arsye se çfarë e ka shkaktuar vonesën në vlerësim të ofertave. Po ashtu autoriteti kontraktues në arsyetimin e datës 21.06.2023 nuk ka provuar të dëshmojë me ndonjë dëshmi konkrete në lidhje me mungesën e mjeteve ashtu siç pretendon, ku këtë e dëshmon edhe lisat e bashkangjitur e Buxhetit të Republikës së Kosovës për këtë aktivitet të prokurimit ku janë ndarë mjetet për vitet 2022, dhe projeksionet e buxhetit për vitin 2023 dhe 2024.

Lidhur me arsyetimin e AK-së, se ka kaluar disa muaj dhe ka skaduar dhe kohëzgjatja e vlefshmërisë të ofertave bazuar në afatin e saktësuar në njoftimin për kontratë në nenin IV 3.3 dhe nenin IV.5 të dosjeje se tenderit periudha e vlefshmërisë se tenderit në dosjen e tenderit. Ekspertja shqyrtuese sqaron se AK është përgjegjëse që të kërkojë nga operatorët ekonomik të zgjatnin validitetin e tenderëve të tyre. Këtë konstatim e bazoj në nenin 30.4 i Rregullores Nr.001/2022 ku është përcaktuar .... *“Kërkesa për zgjatje të validitetit të tenderit do të bëhet me shkrim dhe duhet të kërkojë para datës së skadimit dhe duhet të ngritet në sistem (është e rëndësishme të verifikohet që të gjithë tenderët pranojnë kërkesën për zgjatjen e validitetit të tenderit). Andaj Autoritetit kontraktues është përgjegjës që të ndërmarr veprime në kuptime të nenit 30.4 dhe 30.5 të Rregullores Nr. 001/2022. Po ashtu ekspertja sqaruese sqaron se mos zbatimi i nenit 30.4 klasifikohet si shkelje e rend sipas nenit 97.1 pika f) të Rregullores Nr. 001/2022 për prokurim publik në të cilin thuhet: “f. Mos zbatimi i nenit 30.4 të Rregullores së Prokurimit Publik nga zyrtari përgjegjës i prokurimit dhe si rrjedhojë skadimi të afateve kohore të vlefshmërisë dhe sigurisë së tenderëve”*

Bazuar në platformën e prokurimit kërkesa e AK-së e (fundit )për vazhdimin e validitetit të ofertave ka qenë me datë 22.03.2023, ndërsa oferta e operatorit ekonomik ankues ka pas validitet deri me datë 21.05.2023.

**Prove:**

**KOMUNA E VUSHTRISË**

Për: Departamentin e Prokurimit.

Në: Kompania "ELBAU" sh.p.k. - Ciljan

**Deklaratë për zgjatjen e validitetit të tenderit**

Lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Mbledhja e shërbimeve teknike dhe verifikat" me nr. prokurimit 681-22-11629-5-2-1.

Lidhësit,

Duke u bazuar në kërkesën e Departamentit të Prokurimit të datë 22.03.2023 për lidhjen me validitetin e shërbimeve të tenderit, CP "ELBAU" sh.p.k. - Ciljan, me nr. 01 të kësaj deklarate, pajtohet dhe pajtohet.

**KONFIRMIM**

Zgjatjen e shërbimeve të validitetit të tenderit/ ofertës tëmë për periudhën e kërkuar prej 06 ditësh, prej datës 21.03.2023 deri me datën 21.03.2023 lidhur me aktivitetin e kërkuar.

Më respekt,

Ciljan, më datë 23.03.2023

ELBAU sh.p.k.

Si përfundim, ky aktivitet i prokurimit si proces nuk është proceduar konform afateve ligjore të LPP-së dhe Rregullores Nr. 001/2022, ku si pasojë e neglizhencës dhe pa-përgjegjësisë të autoritetit kontraktues, pëson operatori ekonomik. Andaj, i propozoj bordit të Oshp-së, që të merren masa sipas procedurave dhe rregullave në fuqi ku këtë propozim e bazoj në nenin 97.1 *Shkelje të rënda konsiderohen* pika f) dhe k) të Rregullores Nr. 001/2022.

Gjithashtu duke ju referuar edhe interpretimit të KRPP-së që është organ rregullativ dhe i vetmi i cili interpreton (neni 87, par. 2.7 i LPP-së) dispozitat e LPP-së, si dhe interpretimin për çdo dokument që nxirret nga KRPP, që në rastin konkret "Rregulloren nr.001/2022 për Prokurimin Publik" është dokument i nxjerr nga KRPP, ekspertja sqaron se tek pyetjet e shpeshta 7. 22.11.2022 është dhënë sqarim ..... "*Neni 30.3 i Rregullores për Prokurimin Publik, kërkon rreptësisht që oferta të ketë validitet deri te dhënia dhe nënshkrimi i kontratës. Prandaj KRPP konsideron se asnjë kontratë publike nuk mund të nënshkruhet me validitet të skaduar të ofertës. Për këtë arsye, Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit duhet me kujdesin më të madh të përcjellë validitetin e ofertave, dhe në çdo rast duhet të kërkojë nga të gjithë operatorët ekonomik pjesëmarrës zgjatjen e validitetit të ofertave para datës së skadimit. Në mënyrë retroaktive nuk mund të kërkohej zgjatja e validitetit të ofertave dhe/ose e sigurisë së tenderit. KRPP do të monitorojë me kujdes të veçantë autoritetet kontraktuese për moszbatimin e nenit 30.4 të Rregullores për Prokurimin Publik. Mos zbatimin e nenit 30.4 klasifikohet si shkelje e rëndë sipas nenit 97 të kësaj rregulloreje, andaj KRPP do të ndër marr masa në përputhje me nenin 97 të Rregullores për Prokurimin Publik.*

Bazuar në sqarimet e dhëna në këtë raport vlerësoj se vendimin për anulim të aktivitetit të prokurimit duhet të mbetet në fuqi për faktin se oferta e OE ankues nuk posedon validitet dhe "*Në mënyrë retroaktive nuk mund të kërkohej zgjatja e validitetit të ofertave dhe/ose e sigurisë së tenderit*", sa i përket ankesës së OE ankues, ekspertja konsideron se duhet të trajtohet si e bazuar për arsye të se anulimi i aktivitetit të prokurimit është bërë për shkak të neglizhencës së autoritetit kontraktues ku si pasojë janë penalizuar operatorët ekonomik.

Sa për sqarim dhe në shërbim të transparencës, ekspertja shqyrtuese sqaron se me datë 12.07.2023, përmes e-mailit zyrtar i jemi drejtuar autoritetit kontraktues Komuna Vushtri për sqarime në lidhje me kërkesën për zgjatje e validitetit të ofertave. Në lidhje me këtë kërkesë nuk kemi pranuar përgjigje nga Komuna e Vushtrisë, por deri me datën e lëshimit të këtij raporti (14.07.2023) nuk kam pranuar përgjigje.

## REKOMANDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesat e OE ankues “Lindi Markings” Sh.P.K., “Sinjalizimi” Sh.P.K.& “El-Bau” Sh.P.K., të aprovohen si të bazuara, të mbetet mbetet në fuqi vendimi i AK-së për anulim të aktivitetit të prokurimit.

### *- Konstatimi i Panelit Shqyrtues -*

Paneli Shqyrtues konstatoi se nuk ekzistojnë elementet për parandalim të konfliktit të interesit, siç kërkohet në kuptim të nenit 11 të Rregullores për Punën e OSHP, prandaj analizoi të gjitha shkresat e kësaj lënde, përfshirë të gjitha aktet dhe veprimet e palëve dhe konsideroi se nuk ka nevojë të konvokohet seanca publike me palë sepse ka prova të mjaftueshme për të vendosur sipas paragrafit 1, të nenit 24 të Rregullores së cituar. Paneli në këtë rast mori në konsideratë të gjitha pohimet ankimore, aktet dhe veprimet e AK dhe raportin e ekspertit.

Në fakt (natyrisht pavarësisht nga rekomandimet) Paneli vëren se procedura e prokurimit e cila është aplikuar në këtë rast është prezantuar në detaje në raportin e ekspertizës së ekspertit shqyrtues, duke i shpjeguar të gjitha fazat e procesit dhe veprimet e ndërmarra nga palët në kontekstin krahasues me aktet në fuqi, posaçërisht me Rregullat për Prokurim Publik.

Prandaj duke ju referuar nenit 104.1, të LPP, sipas të cilit kërkohet që procedura e shqyrtimit të zbatohet në mënyrë të shpejt, të ligjshme dhe efektive dhe duke i analizuar po ashtu në tërësinë e tyre shkresat e kësaj lënde në kontekstin e këtij procesi të prokurimit, Paneli nuk e konsideroi të nevojshme ta shtjelloj sërish në detaje dhe pa nevojë në këtë rast secilin pretendim ankimor, përderisa të njëjtat në mënyrë specifike janë veçuar sidomos në vendimin e atakuar të autoritetit kontraktues. Krahas tjerash, në vendimin e atakuar të autoritetit kontraktues dhe në raportin e ekspertit shqyrtues janë dhënë shpjegime lidhur me pohimet ankimore. Paneli vëren se arsyet e dhëna në raportin e ekspertizës janë profesionale dhe të argumentuara pa vërejtje me prova materiale, pa nevojë që të përshkruhen sërish. Prandaj Paneli mbështet shpjegimet e ekspertit shqyrtues i cili ka rekomanduar që lënda të anulohet.

Në bazë të arsytimit të AK se aktiviteti i prokurimit është i vitit 2022 dhe mjetet financiare kanë kaluar në buxhetin e Kosovës si dhe njësia e kërkesës drejtoria për shërbime publike nuk ka arritur të siguroj mjetet financiare për këtë aktivitet për vitin 2023. Si pasojë e gjendjes së krijuar për shkak të mungesë të mjeteve financiare, PSh e mbështet anulimin e këtij aktiviteti të prokurimit, sepse në të kundërtën do të bie ndesh me parimet dhe dispozitat e prokurimit publik dhe AK do të vinte në një gjendje ku do ta kishte të pamundur nënshkrimin e kontratës pa i pasur mjetet në dispozicion.

Sipas nenit 8.3 të RRUOPP, citat: “Nëse AK është autoritet publik ose organizatë buxhetore ZKF do të siguroj që: a. Fondet janë alokuar; ose b. Fonde të mjaftueshme do të alokohen në vitin fiskal në fjalë. Kjo dispozitë do të përfshihet në kontratën publike.”

Paneli shqyrtues me marrjen e vendimeve gjithmonë ka parasysh nenin 1 të LPP-së, ku qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Me qenë se ky aktivitet i prokurimit anulohet pa fajin e operatorëve ekonomik, Vendimi sikurse në pikën 3, të dispozitivit është marrë në kuptim të nenit 31, paragrafi 6, i Rregullores së punës së Organit Shqyrtues të Prokurimit

Ndërsa, Paneli zyrtarit të prokurimit i lëshon vërejtje dhe në qoftë se këto shkelje të LPP të cekura në raportet e ekspertizave përsëriten atëherë do të drejtohet me shkresë KRPP që të njëjtit ti merret certifikata e prokurimit konform nenit 25 të LPP

Andaj nga të lartcekurat, paneli shqyrtues në pajtim me nenin 117 të LPP-së vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Panelit Shqyrtues  
Vedat Poterqoi, Kryetar



**Këshillë Juridike:**

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur ka të drejtë që t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë në afat prej 30 ditësh, nga data e pranimit të këtij vendimi.

**Vendimi t'i dorëzohet:**

- AK- Komuna Vushtrri
- OE ankues
- Arkivës së OSHP-së;
- Për publikim në ueb-faqe zyrtare;